



VENDIM

Nr.103 Datë 17.10.2011

PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUES (HEC FAQEKUQ 1
DHE HEC FAQEKUQ 2) SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "ll", 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "HP OSTROVICA ENERGY" sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues "HEC "Faqekuq 1 dhe Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "HP OSTROVICA ENERGY" sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, germa a,b,c,d**
Pershkrimi i pergjithshem i centralit.
Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, germa a,b,c,d**
Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e pergjithshme, skema funksionale etj.
Ky dokumentacion eshte paraqitur ne menyre korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Kualifikimin e impianteve prodhues Hec "Faqekuq 1" dhe "Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI
Në mungesë dhe me porosi
Entela SHEHAJ